

Rutte: Nuk do të lejojmë
të rrezikohet paqja
në Bosnjë



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

KURTI: QEVERIA E RE DO TË UDHËHIQET NGA LV-ja DHE UNË

FAQE 4-5




Kryeministri i Kosovës, njëherësh lider i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, ka thënë të hënën se ai do të udhëheqë sërish ekzekutivin e ri të dalë nga zgjedhjet parlamentare të 9 shkurtit. Kur

u pyet nga gazetarët nëse ka nisur konsultimet për formimin e qeverisë, Kurti ka thënë se së pari pret rezultatet përfundimtare, pastaj certifikimin e pastaj bisedimet. "Qeveria, e sigurt, e udhëhequr

nga Lëvizja Vetëvendosje dhe unë", ka deklaruar Kurti. Ndërkaq analisti politik Shenoll Muharremi ka theksuar se askush nuk e ka shumicën për ta formuar qeverinë

AKTUALE



GLPS-ja DORËZON PADI PËR
SHFUQIZIMIN E RREGULLORES PËR
PARKINGJET E KRYEQYTETIT F. 3

KOSOVA MUND TË NDJEKË NJË
RRUGË TË RE DREJT NATO-s, QKSS
PROPOZON MODELIN KECI F. 5

OSMANI THOTË SE KOSOVA I
BASHKOHET QËNDRIMIT TË SHBA-së
KUNDËR VEPRIMEVE TË DODIKUT NË
BOSNJË F. 6

EKONOMI



184.3 MILIONË EURO TATIME TË
MBLEDHURA PËR JANAR - SHKURT F. 8

STUDENTËT E FAKULTETIT
EKONOMIK NISIN PRAKTIKËN
PROFESIONALE NË ZKA F. 8

SPORT



SOT DERBI DRITA - BALLKANI F. 6

GATI 300 ZJARRE
PËR TRI DITË NË
KOSOVË, DYSHOHET
SE SHUMICA JANË
SHKAKTUAR NGA
DORA E NJERIUT F. 7



ÇAKOLLI THOTË SE PROBLEMI
ME PARREGULLSITË NË
NUMËRIMIN E VOTAVE ËSHTË
TEK ATA QË NUMËROJNË DHE
PROCESOJNË REZULTATET F. 3



RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@ml.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVIÇË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SHA
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Rutte: Nuk do të lejojmë të rrezikohet paqja në Bosnjë



Sarajevë, 10 mars - Sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Mark Rutte, tha se aleanca mbështet sovranitetin dhe integritetin e Bosnjë-Hercegovinës, duke theksuar se nuk do të lejojë që paqja “e fituar me mund” në këtë shtet të vihet në rrezik. Në një konferencë për medie të hënën në Sarajevë, pas takimit me anëtarët e Presidencës trepalëshe, Rutte tha se situata aktuale nuk është sikur më 1992, kur nisi lufta në Bosnjë. Vizita e Ruttesit u zhvillua në kohën kur autoritetet e Republikës Sërpska, duke kërcënuar me shpërbërje, kanë tentuar ta ndalojnë funksionimin e institucioneve shtetërore të drejtësisë dhe policisë në territorin e këtij entiteti. “Kam dëgjuar shqetësime për situatën e sigurisë. Le të jemi të qartë, kjo situatë nuk është si më 1992 dhe ne nuk do të lejojmë që të krijohet një vakum i sigurisë. Komuniteti ndërkombëtar është këtu dhe është i angazhuar për ta vazhduar mbështetjen tonë të fuqishme, përfshirë përmes EUFOR-it”, tha Rutte. Rutte tha se NATO-ja mbështet sovranitetin dhe integritetin territorial të Bosnjës dhe Marrëveshjen e Paqes së Dejtonit, që tha se është thelbi i paqes në Bosnjë. “Retorika nxitëse dhe veprimet janë të rrezikshme. Ato paraqesin një kërcënim të madh për stabilitetin e Bosnjë-

Hercegovinës dhe të sigurisë”, tha Rutte. Ai tha se çdo veprim që e minon Dejtonin, rendin kushtetues dhe institucionet shtetërore, por edhe retorika nxitëse, “janë të papranueshme”. Rutte tha se këtë situatë duhet ta zgjidhin vetë udhëheqësit e Bosnjës, duke iu drejtuar anëtarëve të Presidencës trepalëshe, teksa theksoi se nga “i gjithë rajoni do të përfitojë nga pajtimi dhe paqja e qëndrueshme në Bosnjë”. Shefi i NATO-s nisi vizitën në Bosnjë është me anëtarët e Presidencës së Bosnjë-Hercegovinës - Zhelka Cvijanoviç, Denis Beqiroviç dhe Zhelko Komshiq.

Tre anëtarë të Presidencës së Bonjës, dy qëndrime të ndryshme

Gjatë konferencës së përbashkët për medie, kryesuesja e presidencës, Zhelka Cvijanoviç, tha se për të dhe përfaqësuesit politikë të entitetit serb nuk është i diskutueshëm integriteti territorial dhe ruajtja e multietnicitetit të Bosnjë-Hercegovinës, si dhe bashkëpunimi me NATO-n, por që ata kundërshtojnë anëtarësimin në këtë aleancë ushtarako-politike. “Kolegët e mi mendojnë se është normale që një i huaj të imponojë ligje,

unë nuk mendoj se është normale që dikush, bazuar në Konferencën e Bonit, të krijojë një kaos të tillë. Në Republikën Sërpska ekziston bindja se kjo shtet është privatizuar në favor të një grupi dhe në dëm të dy të tjerëve përmes spekulimeve të ndryshme”, tha ajo. Cvijanoviç mirëpriti praninë e shtuar të EUFOR-it dhe NATO-s në Bosnjë dhe tha se beson se kjo është e mirë për të gjithë “për shkak të kërcënimeve të ndryshme verbale që kemi pasur mundësinë të dëgjojmë”. “[Përfaqësuesi i lartë në Bosnjë, Christian] Schmidt nuk mund ta shpëtojë Bosnjën, por Republika Sërpska dhe Federata e Bosnjës mund ta bëjnë këtë dhe mendoj se duhet të punojmë për këtë, të arrijmë marrëveshje dhe të jetojmë një jetë normale dhe demokratike”, tha ajo. Anëtarë i Presidencës, Denis Beqiroviç, tha se është e rëndësishme që Rutte tha se NATO-ja nuk do të lejojë një vakum të sigurisë dhe mbështet përfaqësuesin e lartë ndërkombëtar, Schmidt. “Këto janë momentet më të vështira që nga viti 1995 e deri më sot. Kemi pasur një sulm brutal ndaj Kushtetutës së Bosnje e Hercegovinës. Destabilizimi i rrezikshëm duhet të ndalet. E vetmja që do të përfitonte nga destabilizimi është Moskë”, tha ai. Anëtarë i tretë i Presidencës, Zhelko Komshiq, deklaroi se

çdo gjë që ka dëgjuar në takimin me sekretarin e Përgjithshëm të NATO-s, ai do ta nënshkruante menjëherë. Sipas tij, përgjegjësia për Bosnjën “do të mbetet mbi ne” dhe se detyra e tyre është që “kryesisht të sjellim lajme të mira për qytetarët e Bosnjës.” “Një çështje që askush nuk e përmend është nevoja që Bosnja të ndajë më shumë fonde për sektorin e mbrojtjes, duke qenë se flasim për dëshirën për t’u bërë anëtare e NATO-s. Shuma e parashikuar në buxhetin që miratojmë sot nuk është as afër 2 të GDP-së”, tha Komshiq. Përveç takimit me anëtarët e Presidencës, Rutte do të zhvillojë një takim me kryetaren e Këshillit të Ministrave të Bosnje dhe Hercegovinës, Borjana Krishto. Pasditë pritet që Rutte t’u drejtohet studentëve të Fakultetit të Shkencave Politike të Universitetit të Sarajevës. Sekretari i përgjithshëm i NATO-s po viziton në Bosnjë-Hercegovinë pas miratimit të ligjeve antikushtetuese në entitetin Republika Sërpska të Bosnjë-Hercegovinës. Më herët, Kuvendi i RS-së ka miratuar një ligj për ndalimin e veprimtarisë së Agjencisë Shtetërore për Hetime dhe Mbrojtje (SIPA) të BeH-së, Gjykatës dhe Prokurorisë së Bosnjë-Hercegovinës, si dhe Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Prokurorial, i cili është

përgjegjës për emërimin e të gjithë gjyqtarëve dhe prokurorëve në vend. Gjykata Kushtetuese e Bosnjë-Hercegovinës ka marrë një masë të përkohshme dhe ka pezulluar zbatimin e ligjit të miratuar nga Kuvendi Popullor i RS-së më 27 shkurt, një ditë pasi presidenti i RS-së, Millorad Dodik, u dënua nga Gjykata e Bosnjë-Hercegovinës me një vit burgim dhe gjashtë vjet ndalim të ushtrimit të funksionit. Ky është dënim i shkallës së parë, ndaj të cilit Dodik ka mundësi të ankohet. Ai u shpall fajtor për mosrespektimin e vendimeve të përfaqësuesit të Lartë, Christian Schmidt, dhe për nënshkrimin e dekretit për shpalljen e ligjeve që Schmidt i kishte anuluar më herët, me të cilat ishte synuar pengimi i zbatimit të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese të Bosnjë-Hercegovinës dhe përfaqësuesit të Lartë në territorin e RS-së. NATO-ja ka përsëritur disa herë se kjo organizatë ushtarako-politike mbështet sovranitetin dhe integritetin territorial të Bosnjë-Hercegovinës dhe se nuk do të lejojë një vakum sigurie apo rrezikim të paqes së fituar me vështirësi. Forcat e Bashkimit Evropian (EUFOR) në Bosnjë-Hercegovinë njoftuan më 7 mars se do të rrisin përkohësisht numrin e trupave të tyre si një masë parandaluese, pas rritjes së tensioneve në vend.

Rashiti: Është manipuluar me votat në ambasada dhe ato me postë

Prishtinë, 10 mars - Analisti Naim Rashiti ka hedhur kritika sa i përket procesit të zgjedhjeve të 9 shkurtit. Rashiti ka shkruar në "Facebook" se gjatë votimit në ambasada ka pasur manipulim me vota, përcjell kështu edhe nga ato me

postë nga mërgata. Sipas tij, edhe gjatë procesit të numërimit në QNR, komisionarët kanë shkaktuar manipulime. "Dita e mirë e zgjedhjeve nuk mjafton më. As edhe sjellja dinjitoze e votuesve. Procesi u dëmtua nga

aspekte të tjera: 1. Ndryshimet ligjore dhe vendosja për përzgjedhjen e 10 kandidatëve vetëm sa ka krijuar hapësirë me të madhe për manipulim. 2. Votimi në ambasada manipulim. 3. Votimi me postë i manipulueshëm. 4. Procesi i

numërimit dhe orkestrimi i rezultateve nga komisionerët po shkakton manipulime. Vlerësimi i lartë ndërkombëtar për ditën e zgjedhjeve do të zbehet me shumë kritika për procesin e numërimit", ka thënë Rashiti.



GLPS-ja DORËZON PADI PËR SHFUQIZIMIN E RREGULLORES PËR PARKINGJET E KRYEQYTETIT

PRISHTINË, 10 MARS - Grupi për Studime Juridike dhe Politike (GLPS) ka dorëzuar padi për shfuqizimin e Rregullore për Organizimin dhe Shfrytëzimin e Parkingjeve të komunës së Prishtinës. Përmes kësaj padie, GLPS-ja i ka kërkuar Gjykatës Supreme të Kosovës shfuqizimin e Rregullore për Organizimin dhe Shfrytëzimin e Parkingjeve të komunës së Prishtinës si dhe ndalimin e prodhimit të efekteve juridike të saj deri në vendosjen meritore të gjykatës.

Koordinatori i Qendrës për Raste Gjyqësore Strategjike, Liridon Salihu, tha se me këtë padi ka arsyetuar se disa dispozita bien në kundërshtim

me ligjet në fuqi dhe janë të mangëta në përmbajtje. "Me këtë padi kemi kërkuar nga Gjykata Supreme që të vendosë lidhur me ligjshmërinë e rregullore së 'Prishtina Parkingut'. Kjo rregullore e cila ka hyrë në fuqi më 22 janar 2024, ndërsa më 5 prill 2024, GLPS, pas analizimit të këtij akti nënligjor, ka vlerësuar se ka dispozita të tilla që bien në kundërshtim me ligjet në fuqi, po ashtu rregullorja është e mangët sa i përket përmbajtjes së saj", ka thënë ai, duke shtuar se të gjitha këto pretendime të tyre i kanë nisur përmes një kërke drejtuar kryetarit të Prishtinës, Përparim Rama dhe asamblistëve të Kuvendit



Komunal të Prishtinës, që t'i adresojnë këto dhe të hyjnë në procedurën e plotësimit ndryshimit të rregullore. "Duke qenë se as komuna e as kryetari Përparim Rama nuk patën vullnet të hyjnë në

procedurën e plotësimit ndryshimit të rregullore dhe t'i evitojnë të gjitha këto mangësi që ka rregullorja, sot po dorëzojmë padinë në Gjykatën Supreme", ka thënë ai. GLPS-ja ka kërkuar që Gjykata

Supreme ta shfuqizojë tërësisht rregulloren dhe më pas të shohim nëse komuna do të reflektojë për t'i bërë ndryshimet e nevojshme.

Salihu, po ashtu, nënvizoi se para se të hynte në fuqi kjo rregullore, Ministria e Drejtësisë kishte kërkuar nga komuna e Prishtinës ta bëjë rishikimin e rregullore mirëpo, siç tha ai, komuna kishte mbetur e heshtur dhe nuk e kishte marrë parasysh. Ai ka thënë se padisë ia kanë bashkangjitur edhe raportin e fundit që ka bërë Zyra Kombëtare e Auditimit, raport ky që vë në theks se hartimi i kësaj rregullore nuk është bërë sipas një analize të bazuar.

CAKOLLI THOTË SE PROBLEMI ME PARREGULLSITË NË NUMËRIMIN E VOTAVE ËSHTË TEK ATA QË NUMËROJNË DHE PROCESOJNË REZULTATET

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 10 MARS - Problemi me parregullsitë në numërimin e votave nuk qëndron te mënyra e as te vendndodhja e numërimit, por tek ata që i numërojnë, thotë Eugen Cakolli nga koalicioni i organizatave joqeveritare, Demokracia në Veprim.

Ai ka thënë se në vitin 2023 partitë politike ishin pajtuar që numërimi i votave të zhvendosej në qendrat komunale të numërimit për t'i shmangur

manipulimet nga komisionarët. "Megjithatë, pavarësisht kamerave, televizorëve, vëzhguesve, koston dukshëm më të lartë dhe vonesave në përpunimin e rezultateve, këto zgjedhje po tregojnë se problemi vazhdon. Nga rinumërimi i votave të kandidatëve të LDK-së në Vushtrri, vetëm në 15 nga 96 vendvotimet e kësaj komune, nuk ka pasur dallime në vota. Ndërkaq, në plot 35 vendvotime, diferencat janë mbi 10 vota. Edhe nëse nuk vërtetohet në asnjë komunë tjetër, ky rast

tregon se problemi nuk qëndron as tek mënyra dhe as tek vendndodhja e numërimit, por tek ata që numërojnë dhe procesojnë rezultatet. Prandaj, është e domosdoshme që të largohemi nga numërimi dhe përpunimi manual i votave. Një zgjidhje mund të jetë digjitalizimi i numërimit përmes skanimit të fletëvotimeve, të plotësuar me kimik unik - opsion që garanton integritetin por edhe shpejtësinë e procesit", ka shkruar në "Facebook" Cakolli.

Kurteshi: Kemi fakte se procesi i votimit me postë është tërësisht i kontaminuar

PRISHTINË, 10 MARS - Anëtari i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje, Sami Kurteshi, të hënë pas përfundimit të mbledhjes së KQZ-së, tha se Vetëvendosja do të ankohet në Gjykatën Supreme për çështjen e rivotimit me postë nga votat jashtë Kosovës.

Kurteshi shtoi se LV-a, ka nxjerrë prova se si "procesi është tërësisht i kontaminuar". "Ne kemi për t'u ankuar në lidhje me çështjen e rivotimit me postë, nga vota e jashtme për

mërgimtarët tanë, për arsye se kemi nxjerrë shumë dëshmi, fakte, prova se ai proces është tërësisht i kontaminuar. Ne i kemi të dy afatet në dispozicion, një e kemi afatin me u ankuar në vendimin e PZAP-së, sepse e ka hapur derën PZAP-ja ligjërisht 48 orë, por kemi të drejtën që të bëjmë ankesë edhe pas shpalljes së rezultateve përfundimtare", ka thënë ai.

Lëvizja Vetëvendosje e ka akuzuar Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) për shmangie nga



vendimi për rivotimin e votave me postë.

Në këtë kontekst, partia ka

dorëzuar një ankesë për anulimin e këtyre votave dhe kërkesën për rivotim përmes

postës. "Vëzhguesit tanë kanë mbledhur fakte dhe prova për shkelje të shumta të cilat tregojnë ndërhyrje të organizuar në votimin përmes postës nga LDK. KQZ njoftoi se numërimi përfundoi më 5 mars 2025, në orën 21:00, dhe afati për ankesa ishte 48 orë nga ai moment. Ne e dorëzuam ankesën më 7 mars, në orën 20:20, brenda afatit ligjor", thuhej në reagimin e Vetëvendosjes. Në mbledhjen e KQZ-së të hënë u vendos të rinumërohen 50 kuti të votimit.



KURTI: QEVERIA E RE DO TË UDHËHIQET NGA LV-ja DHE UNË

Kryeministri i Kosovës, njëherësh lider i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, ka thënë të hënën se ai do të udhëheqë sërish ekzekutivin e ri të dalë nga zgjedhjet parlamentare të 9 shkurtit. Kur u pyet nga gazetarët nëse ka nisur konsultimet për formimin e qeverisë, Kurti ka thënë se së pari pret rezultatet përfundimtare, pastaj certifikimin e pastaj bisedimet. “Qeveria, e sigurt, e udhëhequr nga Lëvizja Vetëvendosje dhe unë”, ka deklaruar Kurti. Ndërkaq analisti politik Shenoll Muharremi ka theksuar se askush nuk e ka shumicën për ta formuar qeverinë

EPOKA E RE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 10 MARS - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë të hënën se ai do të udhëheqë sërish ekzekutivin e ri të dalë nga zgjedhjet parlamentare të 9 shkurtit. “Së pari rezultatet përfundimtare, pastaj certifikimi, pastaj bisedimet. Qeveria, e sigurt, e udhëhequr nga Lëvizja Vetëvendosje dhe unë”, ka deklaruar Kurti shkurtimisht për gazetarët. Lëvizja Vetëvendosje është fituese e zgjedhjeve të 9 shkurtit me 42.27 për qind të votave të fituara apo 48 ulëse në Kuvendin me 120 vende. Kjo nënkupton se kjo parti nuk mund ta formojë e vetme ekzekutivin e ri, për të cilin duhen 61 deputetë.

Kurti nuk iu përgjigj pyetjeve të gazetarëve se me cilat parti opozitare partia e tij, Lëvizja Vetëvendosje, është më e përafërt. Numri dy në LV, Glauk Konjufca, ka deklaruar për një media italiane se synojnë që ta formojnë qeverinë me partitë joserbe. “Siç e keni parë, qeveria Kurti 2 u formua në bashkëpunim me minoritetet joserbe. Ky është qëllimi ynë, sepse ka pasur ndikim pozitiv në Kosovë, duke parandaluar Listën Serbe, që operon nën ndikimin e Beogradit, që të ketë pushtet vendimtar, siç kishte në qeveritë paraprake”, tha Konjufca për institutin dhe median online me seli në Itali, Osservatorio Balcani e Caucaso Transeuropa. Minoritetet joserbe kanë dhjetë vende të rezervuara në Kuvend.

Nëse LV-ja dhe partitë joserbe bëhen bashkë, do të kishin 58 ulëse - sërish më pak se 61 vota sa kërkohet për formimin e qeverisë. Ministri për Kthim dhe Komunitete, Nenad Rashiq, po ashtu ka fituar një ulëse nga dhjetë vendet e rezervuara për komunitetin serb, ndërkaq nëntë të tjera Lista Serbe, partia më e madhe e serbëve në Kosovë, që gëzon mbështetjen e Beogradit. Por, edhe me mandatin e Rashiqit, LV-së do t’i duheshin edhe dy deputetë që të mbështesnin një ekzekutiv të ri të partisë së kryeministrit Albin Kurti. Kryetari i Kuvendit, Glauk Konjufca, tha se ka pak të ngjarë që LV-ja të bashkëpunojë me partitë që aktualisht janë në opozitë. “Nëse do të jetë e nevojshme ne

do të takohemi si udhëheqës dhe të vendosim për hapat e ardhshëm, por sa iu përket partive opozitare, ato kanë ndërmarrë një qëndrim pengues. Sulmet ndaj LV-së kanë qenë agresive dhe mendoj se këto zgjedhje ishin mjaft jofer, me akuza jofer dhe me goditje të ulëta”, shtoi Konjufca. Subjektet opozitare Partia Demokratike e Kosovës, Lidhja Demokratike e Kosovës dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës janë shprehur kundër bashkëpunimit me LV-në e Kurtit. Por, kreu i Nismës, Fatmir Limaj, i cili ka siguruar tre deputetë në zgjedhjet e 9 shkurtit, ka deklaruar se nuk ka “vija të kuqe” sa iu përket koalicionëve të mundshme, qoftë me LV-në, qoftë me partitë aktuale në opozitë. Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, ka përjashtuar çdo mundësi të bashkëpunimit me Lëvizjen Vetëvendosje për formimin e qeverisë. Ai ka thënë se qeverinë duhet ta formojë opozita dhe, sipas tij, ka komunikim për këtë. “Besoj se veç shihet se shumicën e ka opozita. Kuptohet, pas afateve kushtetuese, opozita mund ta krijojë qeverinë. Besoj kjo është ajo që na takon neve si

opozitarë, që të bashkohemi dhe të krijojmë qeverinë nga opozita. Ka komunikim të ndërsjellë [me opozitën], nuk ka ndonjë avancim konkret, për shkak se janë edhe afatet kushtetuese, por besoj ka gatishmëri që të ecim”, ka thënë Haradinaj.

Shenoll Muharremi:
Sot askush nuk e ka shumicën, nuk i ka votat dhe mandatet e nevojshme për ta krijuar qeverinë

Analisti politik Shenoll Muharremi ka komentuar deklaratën e Kurti se fillimisht pret rezultatet përfundimtare, pastaj certifikimin e pastaj bisedimet për qeveri. “Kur po thotë dhe po e përsëritë disa herë kryeministri ‘së pari rezultatet e certifikimi, pastaj flasim për qeveri’ ta krijon përshtypjen që po thotë disi ‘këto rezultate vështirë kanë për t’u certifikuar’.. Ose ‘kemi me i zvarritë goxha shumë derisa të certifikohen’. Rezultatet në aspektin e mandateve i dimë nga 9 shkurti, nuk është që duhet pritur certifikimin për të biseduar e për t’u dakorduar

KOSOVA MUND TË NDJEKË NJË RRUGË TË RE DREJT NATO-s, QKSS PROPOZON MODELIN KECI

PRISHTINË, 10 MARS - Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) ka publikuar një studim të ri mbi avancimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe NATO-s. Ky punim, i titulluar “Eksplorimi i opsioneve për avancimin e marrëdhënieve Kosovë - NATO”, vjen në një kohë të rritjes së tensioneve gjeopolitike, duke theksuar nevojën për një qasje më të avancuar të Kosovës ndaj

Aleancës Veriatlantike. Studimi propozon një model të ri bashkëpunimi të quajtur “Bashkëpunimi i zgjeruar NATO - Kosovë” (KECI), i frymëzuar nga Studimi i Zgjerimit të NATO-s i vitit 1995, raporton “Telegrafi”. Autori kryesor, Ramadan Ilazi, argumenton se kjo kornizë mund të krijojë një rrugë të qëndrueshme për bashkëpunimin e Kosovës me NATO-n pavarësisht prej

sfidave që dalin nga mosnjohja e vendit nga katër shtete anëtare të Aleancës. Ndërkohë, bashkautorja e studimit, Jeta Loshaj, thekson se konteksti gjeopolitik ka ndryshuar ndjeshëm, duke përmendur anëtarësimin e shpejtë të Suedisë dhe Finlandës si një precedent që mund të ndikojë edhe në rastin e Kosovës. Sipas saj, sulmet e mëparshme në Kosovë dhe rreziqet e sigurisë

tregojnë nevojën për një qasje më të drejtpërdrejtë në Aleancë. Drejtori ekzekutiv i QKSS, Mentor Vrajolli, vlerëson se anëtarësimi i Kosovës në NATO nuk do të ishte i dobishëm vetëm për Kosovën, por edhe për vetë Aleancën. Ai argumenton se një proces i besueshëm integrimi do ta zvogëlonte ndikimin e aktorëve keqdashës në rajon dhe do ta shkurtonte barrën

financiare të anëtarëve të NATO-s në raport me misionin e KFOR-it në Kosovë. Ky publikim përkon me vizitën e sekretarit të përgjithshëm të NATO-s, Mark Rutte, në rajon. Sipas QKSS, ndërsa vizita dëshmon shqetësimin e NATO-s për situatën në Kosovë dhe Bosnjë-Hercegovinë, nevojiten hapa konkretë për ta garantuar stabilitetin afatgjatë të sigurisë në rajon.



për formim të qeverisë. Kanë pasur kohë që një muaj për të bërë marrëveshje dhe për të treguar kush dhe si e formojnë qeverinë. Por nuk e kanë bërë dhe sot askush nuk e ka shumicën, nuk i ka votat dhe mandatet e nevojshme për ta krijuar qeverinë. Përndryshe sot tha, ‘unë e formoj dhe udhëheq qeverinë’. Ok-ej, formoje nëse mundesh, por bëhu transparent se si? Një muaj tashmë kaloi!”, ka theksuar Muharremi. Ai ka thënë se legjitimitetin me vota e ka fituar për ta formuar qeverinë, por me gojë të veten duke i ofenduar partitë e tjera e duke i quajtur ‘hajvana’ e ka humbur kredibilitetin e partnerit potencial. “48 LV +10 pakicat joserbe +1 NR = 59 mandate/vota/ në dispozicion, nuk bëjnë 61 sa nevojiten. Pa tregu ku i ka edhe së paku dy mandate/vota të tjerë, nuk mundemi për ta kuptuar seriozisht, por më shumë ndoshta si bluf. E pastaj është punë tjetër nëse dëshiron për

ta formuar, pa së paku një parti opozitare të madhe - qeverinë, e me qenë aq e dobët dhe paqëndrueshme sa që edhe era më solide ta rrëzoj sikur një kullë prej rëre. E pastaj për të shkuar në zgjedhje përsëri, ende pa u përpiluar e aprovuar planin e punës së qeverisë ose pa e bërë ndonjë punë të hajrit”, ka shkruar Muharremi. Analisti Muharremi ka theksuar se Kosova ka nevojë për një qeveri stabile dhe kompetente që i adreson nevojat e brendshme reformatore dhe zhvillimore. “Sidomos një qeveri që di me navigu në botën e trazuar ku arkitektura e sigurisë dhe aleancat historike globale po shemben si kurrë më parë gjatë 100 viteve të fundit”, ka thënë Muharremi.

KQZ-ja vendos për rinumërimin e 50 kutive të votimit

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka vendosur të

rinumërojë 50 kuti të votimit për zgjedhjet parlamentare të 9 shkurtit. Këshilli i Operacioneve Zgjedhore ka rekomanduar që 15 kuti votimi në mbarë Kosovën, të rinumërohen për shkak se, sipas Arianit Elshanit, përfaqësuesit të Partisë Demokratike të Kosovës në KQZ, ka pasur mospërputhje në listën e nënshkrimeve. “Janë identifikuar 15 vendvotime në të cilat ka mospërputhje mes një nënshkrimi dhe dy nënshkrime, pra dy nënshkrime në listën e nënshkrimeve dhe një fletëvotim ose dy më pak, ose më shumë, në kutinë e votimit”, tha Elshani. Rekomandimi i dytë ishte për rinumërimin e 35 kutive në komunën e Vushtrrisë, të cilat më herët ishin numëruar me vendim të prokurorit. Ky rekomandim ka të bëjë me mospërputhje që kishte në rezultatet e kandidatëve për

deputetë të Lidhjes Demokratike të Kosovës. “Këtë raport të mospërputhjeve apo të ndryshimeve mes rezultateve në Qendrat Komunale të Numërimit dhe rezultatet e dala nga hetimi në Qendrën për Numërim dhe Rezultate ka ardhur si rekomandim që 35 vendvotime për të cilat vërehet, pra është më e dukshme diferenca mes votave të kandidatëve, të shkojnë në rinumërim të plotë në Vushtri për të gjitha subjektet politike dhe kandidatët”, tha Elshani. Nga Sekretariati i KQZ-së thanë se janë të gatshëm që rinumërimi i këtyre kutive të votimit të nisë pasditen e së hënës, përkatësisht nga ora 16:00. Ndërkaq, sa iu përket 177 kutive të votimit me vota me postë, të shpallura të pavlefshme, që Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa ka urdhëruar rivlerësimin e tyre, Sekretariati

i KQZ-së tha se po pret të kalojë afati për ankesa në Gjykatën Supreme dhe hapja e këtyre kutive mund të nisë të martën, më së largu të mërkurën. Më 5 shkurt Komisioni Qendror i Zgjedhjeve njoftoi për përfundimin e numërimit të të gjitha votave për zgjedhjet e 9 shkurtit. Pas kësaj, partitë dhe kandidatët kanë drejtuar ankesat e tyre në PZAP dhe më pas në Supreme. Pas përfundimit të afateve për ankimim, KQZ mund ta certifikojë rezultatin zgjedhor dhe t’i hapë rrugë formimit të institucioneve të reja të Kosovës. Një ditë më parë Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) ia ka hedhur poshtë si të paafatshme Lëvizjes Vetëvendosje kërkesën për shfuqizimin dhe përsëritjen e votimit përmes postës në mërgatë të zgjedhjeve parlamentare të muajit të kaluar.

KURTI: KEMI PROVA SE SERBIA NDËRHYRI DREJTPËRDREJT NË ZGJEDHJET E 9 SHKURTIT

PRISHTINË, 10 MARS - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, e ka akuzuar Serbinë të dielën se ka ndërhyrë drejtpërdrejt në zgjedhjet parlamentare të 9 shkurtit në Kosovë, dhe se ka ndikuar në zgjedhjen e deputetëve serbë dhe të pakicave të tjera. “Aparati shtetëror i Serbisë ka bërë përpjekje të jashtëzakonshme t’i dëmtojë subjektet rivale serbe, veçanërisht Partinë për Liri, Drejtësi e Mbijetesë dhe Partinë Demokratia Serbe, si dhe votuesit e subjekteve të komuniteteve të tjera, kryesisht romë dhe ashkali”, tha ai. Partia për Liri, Drejtësi e Mbijetesë udhëhiqet nga Nenad Rashiq, i cili është ministër në qeverinë e Kurtit, i emëruar pas largimit të Listës Serbe nga institucionet e Kosovës. Rashiq, duke folur përkrah Kurtit në konferencë në Prishtinë, tha se autoritetet serbe i përdorin serbët e Kosovës si mekanizëm për menaxhim, por edhe si element për destruktivitet. “Ata nuk duan që ne të kemi integritet të plotë dhe një jetë në harmoni në Kosovë, por pikërisht të kundërtën”, tha Rashiq. Përfaqësues të caktuar nga pothuajse të gjitha subjektet e tjera politike serbe janë tërhequr nga gara pas kërcënimeve që kanë marrë, sipas Kurtit. Ai tha se këto raste janë shënuar në katër komunat me shumicë serbe në veri të



Kosovës, por edhe në gjashtë komunat e tjera në jug të vendit. “Për shumicën e këtyre rasteve, institucionet tona kanë dëshmi të cilat për hir të privatësisë dhe sigurisë së qytetarëve serbë, nuk është e dobishme të bëhen publike”, tha Kurti. Serbia i ka mohuar akuzat për ndërhyrje në zgjedhje në Kosovë. Shefi i Zyrës për Kosovën në Qeverinë e Serbisë, Petar Petković, tha se Kurti paraqiti “një sërë gënjeshtërash dhe manipulimesh famëkeqe”. “Beogradi, i udhëhequr nga Aleksandar Vučić, do të vazhdojë ta mbështesë Listën

Serbe dhe popullin serb në Kosovë dhe do të vazhdojë ta bëjë këtë publikisht dhe në mënyrë transparente”, tha Petković. Misioni vëzhgues i BE-së, në prezantimin e gjetjeve preliminare të tij për zgjedhjet e 9 shkurtit, tha se Serbia kishte ndërhyrë në zgjedhje përmes trysnisë ndaj votuesve serbë në Kosovë. Serbia u akuzua edhe nga Gjermania për ndërhyrje në zgjedhjet në Kosovë. Sipas të dhënave të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të Kosovës, Lista Serbe - e cila gëzon mbështetjen e Beogradit

zyrtar - ka marrë mbi 38 000 vota, ndërsa partia e Rashiqit rreth 4.000 vota. Kushtetuta e Kosovës garanton dhjetë nga 120 vendet e Kuvendit për komunitetin serb dhe dhjetë të tjera për komunitetet e tjera joshumicë. Marta Temido, shefe e delegacionit të Evropian, tha në fund të shkurtit se misioni vëzhgues ka gjetur se autoritetet serbe ndërhyjnë në zgjedhjet e Kosovës duke mbështetur Listën Serbe - njërin prej gjashtë partive serbe që morën pjesë në zgjedhje.

Kurti e akuzoi Serbinë për ndërhyrje hibride, përmes joshjes dhe kushtëzimit financiar, shantazhit, frikësimit dhe kërcënimit për t’i detyruar votuesit të votojnë për Listën Serbe. Ai theksoi se autoritetet e Kosovës “kanë identifikuar shtatë instanca apo aktorë shtetërorë, i pari presidenti i Serbisë Aleksandar Vučić, i dyti kryeterroristi Millan Radoičiq, shefi i Zyrës për Kosovën në Qeverinë e Serbisë, Petar Petković, Agjencia Serbe e Inteligjencës (BIA), mediet serbe të kontrolluara nga pushteti, Lista Serbe dhe strukturat e jashtëligjshme serbe”. “Vetë presidenti i Serbisë ka nxitur çdo aktor shtetëror dhe joshetëror serb të përfshihet në zgjedhjet e Kosovës. Për këtë qëllim rol ekzekutiv ka pasur kryeterroristi Millan Radoičiq, apo njeriu i cili ka marrë detyrat për Kosovën nga presidenti i Serbisë”, tha Kurti. Kryeministri Kurti tha se Serbia përdori “të paktën 10 metoda” për të ndërhyrë në zgjedhje, si joshja financiare përmes përfitimit të një pagese mujore rreth 170 euro për të gjithë personat e moshës madhore, kërcënimi i humbjes së benefiteve financiare, përçarja e rivalëve të Listës Serbe, shantazhi e presioni për të mos mbështetur subjekte të tjera pos Listës Serbe.

OSMANI THOTË SE KOSOVA I BASHKOHET QËNDRIMIT TË SHBA-SË KUNDËR VEPRIMEVE TË DODIKUT NË BOSNJË

PRISHTINË, 10 MARS - Presidentja Vjosa Osmani tha se Kosova i bashkohet deklaratës së sekretarit amerikan të Shtetit, Marco Rubio, dhe rithekson mbështetjen e plotë për integritetin dhe sovranitetin territorial të Bosnjë-Hercegovinës. “Ne gjithashtu dënojmë fuqishëm çdo veprim që minon themelet e Bosnjë-Hercegovinës, sepse kërcënon paqen dhe stabilitetin që rajoni ynë ka punuar palodhshëm për ta arritur - përmes sakrificave shumëvjeçare dhe me mbështetjen e palëkundur amerikane”, shkroi Osmani në X. Sekretari amerikan i Shtetit, Rubio, tha të shtunën se veprimet e presidentit të Republikës Sërpska (RS), Millorad Dodik, përbëjnë kërcënim për sigurinë dhe stabilitetin e Bosnjë-Hercegovinës, si dhe i minojnë institucionet shtetërore të saj. Dodiku i dekretoi më 5 mars ligjet e miratuara nga Kuvendi i Republikës Sërpska - entiteti serb i Bosnjës - të cilat ndalojnë punën e Gjykatës, Prokurorisë, Agjencisë Shtetërore të Hetimeve (SIPA) si dhe Këshillit



të Lartë Gjyqësor e Prokurorial të Bosnjës në territorin e këtij entiteti. Por, më 7 mars, Gjykata Kushtetuese e Bosnjë-Hercegovinës i shpalli jokushtetuese këto ligje, duke i pezulluar përkohësisht, ndërsa pritet t’i ndalojë ato

përfundimisht pas një shqyrtimi të plotë. Liderët në Sarajevë dhe mbështetësit perëndimorë të Bosnjës i kanë akuzuar liderët etnikë të RS-së se po synojnë ndarjen eventuale nga Bosnja, ndonëse këta të fundit i kanë

mohuar akuzat. Disa veprime të tjera të lidhura me këtë entitet kanë përshkallëzuar tensionet në muajt e fundit. Gjykata e Bosnjës e dënoi Millorad Dodikun, presidentin e Republikës Sërpska, me një

vit burgim dhe ia ndaloi ushtrimin e detyrës së presidentit për gjashtë vjet. Dodik - i cili ka lidhje të ngushta me Rusinë dhe i ka mohuar akuzat - është nën sanksione nga ShBA-ja dhe Mbretëria e Bashkuar për veprimet që, sipas qeverive perëndimore, synojnë ndarjen e Republikës Sërpska nga Bosnja. Sistemi i qeverisjes në Bosnjë-Hercegovinë, vend me rreth 3.1 milionë banorë, është ndër më të ndërlikuarit në botë. Që nga Marrëveshja e Dejtonit për paqe, e cila u nënshkrua në vitin 1995 dhe i dha fund luftës në Bosnjë, vendi përbëhet nga Federata Boshnjako-Kroate dhe Republika Sërpska e dominuar nga serbët etnikë, nën një qeveri të dobët qendrore. Derisa Republika Sërpska mund të miratojë ligje për çështje të brendshme, ligjet dhe institucionet në nivel shtetëror mbeten mbi të gjitha, sipas Kushtetutës. Bosnjë-Hercegovina dhe Kosova nuk e njohin njëra-tjetrën për shkak të kundërshtimit nga Republika Sërpska.

Deçani përgatit agjendën e aktiviteteve për 24 marsin

DEÇAN, 10 MARS - Kryetari i komunës së Deçanit, Bashkim Ramosaj, ka takuar Këshillin Organizativ së bashku me shoqatat e dala nga lufta e Ushtrisë

Çlirimtare të Kosovës, për ta përcaktuar agjendën e aktiviteteve në nderim e përkujtim të 24 Marsit të vitit 1998, të lavdisë e krenarisë kombëtare. “Në

përkujtim të luftëtarëve të rënë për liri dhe në përkujtim të 27-vjetorit të ‘Epopesë së Dukagjinit’, betejës që bëri kthesën e historisë sonë nga familja

Haradinaj. Dhe njëkohësisht 24 Marsit të vitit 1999 të ndërhyrjes së forcave të NATO-s në Kosovë”, ka shkruar Ramosaj në “Facebook”.



Gati 300 zjarre për tri ditë në Kosovë, dyshohet se shumica janë shkaktuar nga dora e njeriut

PRISHTINË, 10 MARS - Drejtori ekzekutiv i Agjencisë së Menaxhimit Emergjent (AME) të Ministrisë së Punëve të Brendshme, Genc Metaj, ka deklaruar se situata e zjarreve në Kosovë është jashtë normales, me shumicën prej zjarreve që dyshohet se janë shkaktuar “nga dora e njeriut”. Sipas të dhënave të AME-së, vetëm nga e premtja deri më sot janë regjistruar 294 raste të zjarreve, ndërsa gjatë javës së parë të marsit ishin raportuar 57 raste të tjera.

Në një konferencë për medie, Metaj tha se zjarret më të rrezikshme aktive janë në fshatra të Drenasit, Kamenicës dhe Malishevës.

Një nga shqetësimet kryesore të autoriteteve është se pothuajse të gjitha këto zjarre besohet se janë shkaktuar nga dora e njeriut. “Dyshimet tregojnë që janë të shkaktuara nga faktori njeri, përjashtimisht një rast që është në Novobërdë, i cili dyshohet të ketë qenë si shkak energjia elektrike. Në të gjitha [të tjerat] dyshohet se [shkaktar] është faktori njeri”, tha Metaj.

Ai tha se është ende herët për të ditur se sa janë dëmet nga këto zjarre.

Sipas Sistemit Evropian të Informacionit për Zjarret në Pyje (EFFIS), gjatë vitit 2024 në Kosovë ishin regjistruar 94 zjarre, të cilat kishin djegur gjithsej 12 079 hektarë pyje dhe shkurre.

Si rezultat i zjarreve aktuale, Metaj tha se është rritur gatishmëria në nivel vendi dhe



janë ndërmarrë hapa për patrullime të rregullta të zjarrfikësve në të gjitha komunat. Po ashtu, Policia e Kosovës është angazhuar për t'i shtuar patrullimet dhe hetimet për t'i ndëshkuar përgjegjësit. Edhe pse Kosova ka 739 zjarrfikës aktivë, një numër që Metaj tha se konsiderohet i mjaftueshëm për situata

normale, rastet e fundit kanë vënë në vështirësi operacionet e shuarjes së zjarreve. “Por, këto situata jashtë normales në të cilat jemi sot, vënë në rrezik edhe operacionalitetin, sepse janë të shpërndara në numër të madh në gjithë vendin. Numri i 294 rasteve për tri ditë është i paimagjinueshëm. Është enorm”, shtoi Metaj.

Agjencia e Menaxhimit Emergjent u ka bërë apel qytetarëve t'i raportojnë menjëherë rastet e zjarreve dhe të dyshuarit për zjarrvënie, duke theksuar se një gjë e tillë mund të bëhet edhe në mënyrë anonime.

“Inkurajojmë qytetarët të mos hezitojnë t'i raportojnë rastet dhe personat e involvuar, në mënyrë që të

kemi parandalim dhe zvogëlim të rreziqeve. Kjo situatë po vë në rrezik jetën e qytetarëve si dhe pronën publike dhe private”, tha Metaj.

Sipas Kodit Penal të Kosovës, kushdo që ndez qëllimshëm zjarr dënohet me burgim prej gjashtë muaj deri në 10 vjet, varësisht nga dëmi i shkaktuar nga zjarrvënia.

Nisin punimet për sheshin “Xhorxh Bush”



PRISHTINË, 10 MARS - Kryetari i komunës së Prishtinës, Përparim Rama, ka bërë me dije se sot kanë nisur për sheshin “Xhorxh Bush”. Ai ka thënë se ky është një hap i madh drejt transformimit të kësaj hapësire në një oazë të vërtetë urbane. “Prioriteti ynë kryesor është të ofrojmë sa më shumë hapësirë për qytetarët, veçanërisht për fëmijët, dhe të krijojmë një mjedis të gjelbër. Hapësirat publike do të jenë të

rrethuara nga zona të mbushura me pemë, duke krijuar një ekosistem të jetesës dhe një mikrosistem të natyrës që bashkëjeton në harmoni me qytetin. Po ashtu, dizajni i ri do të sigurojë qasje të lehtë për të gjithë, duke garantuar se çdo qytetar, pavarësisht moshës ose aftësive, do të mund të shijojë këtë hapësirë pa pengesa”, ka thënë Rama. Ai ka shtuar se, përveç hapësirave të gjelbra dhe

zonave të lojërave, do të krijohen edhe kënde të dedikuara për aktivitete kulturore, artizanale dhe rekreative që do të kontribuojnë në zhvillimin e kulturës dhe traditave lokale. Sipas Ramës, sheshi “Xhorxh Bush” do të bëhet pikë e rëndësishme referimi për të gjithë ata që kërkojnë një qasje më të shëndetshme në jetën urbane.

Nisin punimet për Qendrën për Punë Sociale në Hajvali

PRISHTINË, 10 MARS - Të hënën kanë nisur punimet për Qendrën për Punë Sociale në Hajvali, një vend ku qytetarët më

në nevojë do të gjejnë mbështetje dhe kujdes. Kryetari i Prishtinës, Përparim Rama, ka thënë se shërbimet sociale nuk

janë thjesht institucione, por pika mbështetjeje për ata që kanë më së shumti nevojë. Ai ka thënë se bashkë me drejtoreshën

për Mirëqenie Sociale, Adelina Sahiti, po punojnë që askush në kryeqytet të mos ndihet i harruar.



AKB-ja i bën thirrje qeverisë të mos lejojë shtrenjtimin e energjisë elektrike

PRISHTINË, 10 MARS - Paralajmërimi për rritjen e çmimit të energjisë elektrike 35 % është prituri me shqetësim nga përfaqësuesit e bizneseve në Kosovë pasi, sipas tyre, kjo rritje do të ndikojë në shpenzimet dhe qëndrueshmërinë ekonomike. Kryetari i Aleancës Kosovare të Bizneseve (AKB), Agim Shahini, ka thënë se një vendim i tillë do ta rendiste Kosovën në nivel me vendet e Evropës me çmimet e larta

të energjisë elektrike. Ai i ka bërë thirrje qeverisë të mos lejojë një shtrenjtim të tillë. “Paralajmërimi për shtrenjtimin e energjisë elektrike prej 35-përqindësh është ndoshta një kërkesë që secili qytetar dhe biznes e ka marrë me shqetësim të madh, për arsye se me këtë vendim rriten tërë shpenzimet dhe ngarkesat e çdo ekonomie familjare dhe çdo biznese, e kjo do të jetë në pikëpyetje për

qëndrueshmëri të bizneseve. Prandaj, Kosova aktualisht e ka energjinë elektrike më të shtrenjtën në region, por kjo do të ngrehë Kosovën në nivel të shteteve të Evropës me shtrenjtim të energjisë elektrike. Prandaj qeveria do të duhej ta shikojë këtë kërkesë seriozisht dhe mos të zbatojë ose mos ta lejojë ZRRE-në që të vijë deri te ngritja e çmimit”, ka thënë ai për “Ekonomia Online”.



Qeveria ndan mjete financiare për përmbushjen e obligimit të arbitrazhit që lidhet me “Grand Hotel”-in

PRISHTINË, 10 MARS - Qeveria e Kosovës ka mbajtur mbledhje elektronike në të cilën ka miratuar disa vendime me interes. Ekzekutivi i vendit ka miratuar listën e aplikimeve për raundin 10B të granteve investuese të Kornizës Investuese të Ballkanit Perëndimor (WBIF) për projektet si në vijim: Impiantin për trajtimin e ujërave të zeza në Podujevë dhe projektin për përmirësimin e rrjetit të transimisionit VII. Po në këtë mbledhje, siç njofton Zyra e Kryeministrit, është ndryshuar dhe plotësuar Vendimi i Qeverisë nr. 02/39 të datës 3 qershor 2020.



Në mbledhjen elektronike është aprovuar Nisma për Amendamentimin e Marrëveshjes

ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Italisë për Grantin e Realizimit të Projektit “Mbështetje për Sistemin Shëndetësor të Kosovës”. Po sipas njoftimit, në këtë mbledhje janë ndarë mjetet financiare për përmbushjen e obligimit të arbitrazhit për rastin “ICSID me nr. ARB/17/25, Mabco Contructions”. Ani se nuk është përmendur shumat financiare në këtë njoftim, mësohet se bëhet fjalë për mbi 7 milionë euro. Gati 20 vjet pas tentativës së dështuar për privatizimin e

“Grand Hotel”-it në Prishtinë, shteti i Kosovës i ka paguar mbi 7 milionë euro kompanisë “Mabco Construction”, që fitoi gjyqin në arbitrazhin ndërkombëtar në fillim të janarit. Kjo kompani, në pronësi të Behgjet Pacollit, deputet dhe ish-president i Kosovës, pretendon se i është bërë padrejtësi, pasi ka paguar për aksione të hotelit që nuk i mori kurrë, pati shkruar REL. Ministria e Drejtësisë e Kosovës ka pranuar se do të duhet ta kryejë këtë pagesë, por ka theksuar se “Grandi” do të mbetet në pronësi të Kosovës”.

184.3 milionë euro tatime të mbledhura për janar - shkurt



PRISHTINË, 10 MARS - Administrata Tatimore e Kosovës ka njoftuar se vitin e ri fiskal po e nisin me 184.3 milionë euro tatime të mbledhura për muajt janar - shkurt. “Viti i kaluar ishte një vit i jashtëzakonshëm për ATK-në, në aspektin e realizimit të objektivave, por edhe i vlerësimeve nga institucionet ndërkombëtare. Në vitin 2024 janë mbledhur të hyra rekorde, duke tejkaluar parashikimet dhe duke konfirmuar angazhimin e menaxhmentit

dhe stafit të ATK-së për një sistem tatimor efikas, të drejtë dhe transparent. Sot raportojmë për tendencën e rritjes së qëndrueshme të të hyrave tatimore për këtë vit. Të dhënat statistikore për dy muajt e parë të vitit 2025 tregojnë se këto të hyra premtojnë realizimin e projekcionit të planifikuar. Janë gjithsejtë 184.3 milionë euro tatime të mbledhura vetëm për këta dy muajt, që në krahasim me janar - shkurt nga viti 2024 janë 7.2 % më

shumë, apo 12.3 milionë euro”, ka njoftuar ATK-ja. ATK-ja ka njoftuar se do të vazhdojë angazhimin për ta lehtësuar përmbushjen vullnetare të tatimeve, për ta rritur mbikëqyrjen dhe për t'i përmirësuar mekanizmat e institucionit. “Do të vazhdohet implementimi i projekteve dhe reformave të reja, që synojnë rritjen e disiplinës tatimore dhe përmirësimin e ambientit të të bërit biznes”, ka njoftuar ATK-ja.

Studentët e Fakultetit Ekonomik nisin praktikën profesionale në ZKA

PRISHTINË, 10 MARS - Pesëmbëdhjetë studentë të Fakultetit Ekonomik të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” sot filluan praktikën profesionale në Zyrën Kombëtare të Auditimit (ZKA) në kuadër të zbatimit të marrëveshjes së bashkëpunimit të nënshkruar vitin e kaluar ndërmjet dy institucioneve.

Studentët u mirëpritën nga zëvendësauditori i përgjithshëm, Beza Halilaj, dhe zyrtarët e tjerë të menaxhmentit të lartë, të cilët i informuan studentët mbi rëndësinë e auditimit publik, rolin e ZKA-së dhe pritshmëritë nga praktika profesionale. Pas prezantimeve hyrëse, studentët nënshkruan kontratat e

praktikës, duke zyrtarizuar kështu angazhimin e tyre për tre muajt e ardhshëm. Studentët janë bërë pjesë e ekipeve audituese të ZKA-së dhe përgjatë tre muajve do të jenë pjesë e procesit të auditimit në institucionet publik përkatëse ku do t'i aplikojnë njohuritë e fituara gjatë studimeve.



MOS MENDONI PËR POLITIKËN, JETONI SI FORREST GUMPI?!



Nga: Simon INGS / *The Daily Telegraph* (titulli: *Politics? This scientist thinks we shouldn't think too much about it*)

Në fund të filmit të tij të vitit 1940, Diktatori i madh [The Great Dictator], Charlie Chaplin, i veshur me rrobat qesharake të Adolf Hitlerit, e drejtoi shikimin nga kamera dhe shpalli luftë kundër “njerëzve-makina me mendje-makine”, të cilët edhe atëherë po marshonin brutalisht përmes botës së tij. Dhe, ata nuk janë zhdukur. Në fakt, nëse i besoni Leor Zmigrodit, mund të jeni edhe ju – pa e ditur – një robot i pandryshueshëm dhe dogmatik. Zmigrod, një neuroshkencëtarë e re nga Kembrixhi, studion “rigjeditetin kognitiv”. Si duket kjo në botën reale? Jimmy McGill, protagonisti i serialit Bëni mirë të telefoni Saulin [Better Call Saul], na ofron një shembull të një prej manifestimeve të tij: “Gabimi i kostove të fundosura. Kjo është ajo që bëjnë kumarxhinjtë. Hedhin shuma parash pas mendimeve të këqija se mund ta ndryshojnë fatin. Është sikur thonë: ‘Kam shpenzuar tashmë kaq shumë para, apo kohë, çfarëdo. Duhet të vazhdoj’!” Dhe, siç shton Jimmy: “Nuk ka asnjë shpërblim në fund të kësaj loje”. Ambicia e Zmigrodit ka qenë të ringjallë projektin e fisnikut francez të shekullit XVIII,

Antoine Destutt de Tracy, shkenca e të cilit mbi “ideologjinë” kërkonte një metodë rigorozë për të zbuluar kur idetë janë të gabuara dhe të pabesueshme. (Kjo ishte shenja ime e parë paralajmëruese. Nëse një burrë me mantel të bardhë do të më thoshte se idetë e mia janë “objektivisht të pabesueshme”, do të kërkoja shkopin më të madh që do të mund të gjeja. Por, le të vazhdojmë me idenë.) Një yll tjetër më i ndritshëm orientues, në përpjekjen e Zmigrodit, është Else Frenkel-Brunswik, një refugjate austriake në Amerikë, e cila në vitet ‘50 të shekullit XX eksperimentoi me fëmijët për të kuptuar nëse mund të parashikonte dhe trajtonte “mendjet-makina”. Frenkel-Brunswik e pati të lehtë të dallonte fëmijët me paragjykime edhe ata pa paragjykime, ksenofobët nga liberalët. Ajo zbuloi se fëmijëria e zhytur në bindje dhe konformizëm jo vetëm që nxiste autoritarizmin, por gjithashtu i bënte fëmijët më pak fleksibilë nga ana njohëse, aq sa e kishin të vështirë të përballeshin me paqartësitë e përditshme. Madje, edhe ndarja e ngjyrave i linte të hutuar dhe të pakënaqur. Zmigrod argumenton se stili i përpunimit të informacionit nga një mendje dogmatike nuk kufizohet vetëm në trajtimin e informacionit ideologjik. Është “një dëmtim më i përgjithshëm kognitiv që manifestohet kur individi dogmatik vlerëson çdo

informacion, madje edhe brenda një të qindte të sekondës”. Rigjediteti kognitiv, pra, shkon paralelisht me rigjeditetin ideologjik. “Kjo mund të duket e qartë për disa”, shkruan Zmigrod. “Një person rigjid është person rigjid. Por, në fakt, këto modele nuk janë të dukshme”. Por, janë, dhe ky është problemi. Mirëpo, në 200 faqet brenda Trurit ideologjik [The Ideological Brain], ato janë edhe më të dukshme sesa kur Zmigrod fillimisht tha se nuk ishin. Ajo zbulon, me njëfarë dramatizimi, se në një nga studimet e saj, “veprimet nga bindja shkaktojnë modele të aktivitetit nervor që ishin ndryshëm të ndryshme nga ato të shkaktuara nga zgjedhjet e lira”. Sigurisht që po. Nëse mendja mund të bëjë dallimin midis veprimit të lirë dhe nga bindja, dhe nëse mendja është një pronë e trurit në punë, atëherë një skaner i mjaftueshëm i avancuar do të ishte në gjendje të dallonte “ndryshimet në aktivitetin nervor” – në rastet e tilla. Përsëri e përsëri, Zmigrod e ripaketon lajmin për përmirësimet në teknikat e skanimit të trurit si një zbulim mbi mendjen. Është truku më i vjetër në librin e autorëve të neuroshkencës. Zmigrod filloi punën mbi Trurin ideologjik në të njëjtën kohë kur Donald Trump u bë për herë të parë president i ShBA-së dhe Britania votoi për t’u larguar nga BE-ja. Shkrimi i saj është i arrirë

dhe na shëtit në mënyrë argëtuese nga demagogjia deri te marrja e dopaminës, por alarmi i freskët i asaj periudhe shfaqet vazhdimisht në këndvështrimet e saj. Ajo është vazhdimisht armiqësore ndaj të gjitha sistemeve të besimit; kur shkruan për një studim të saj të vitit 2016 që tregonte se “ekstremi i djathtë dhe ekstremi i majtë ishin të ngjashëm nga aspekti kognitiv”, më bëri të mendoj nëse vërtetimi laboratorik i kësaj aksiome kontribuon realisht në kuptimin e vlerave, apo mungesës së tyre, në këto ideologji. Ndonjëherë duket se Zmigrod sikur e sheh vetë besimin si diçka të brendshme. Në kapitullin e fundit, ajo na paraqet idenë e saj për jetën e mirë: “Asnjë presion, asnjë paracaktim, asnjë paraardhës mbi supe apo ritual për t’iu bindur, asnjë pritshmëri që të rëndon ose të pengon lëvizjen”. Më duhej ta lexoja disa herë para se ta besoja. Pra, alternativa e saj ndaj dogmatizmit është të jesh Forrest Gump? Teza e Zmigrodit supozon se njerëzit janë një njësi e pandashme. Nuk janë. (Gjatë punës sime, kam takuar anëtarë të milicive të ekstremit të djathtë dhe ata mbeten ndër njerëzit më mendjehapur me të cilët kam debatuar ndonjëherë.) Ajo gjithashtu duket se supozon se funksionimi i mendjes mund të lexohet nga një skaner. Nuk jam kundër materializmit të rreptë si koncept, por imagjinoni të

shpjegoni funksionimin e një çipi kompjuteri duke përshkruar ikonat në ekranin e kompjuterit: kjo është pak a shumë mënyra se si Zmigrod përshkruan të menduarit. Për më tepër, fakti i qartë se truri plakët, dhe me të edhe mendja, nuk përbën kurrë faktor në argumentin e Zmigrodit. Ndryshimet në fleksibilitetin njohës mund të shpjegohen thjesht nga procesi i plakjes, pa qenë nevoja për makina që bëjnë “bip”. A është e paarsyeshme të pritët që një mendje e re të jetë më liberale dhe më e hapur ndaj eksplorimit, ndërsa një mendje e vjetër të jetë më konservatore, më e përkushtuar ndaj përvetësimit të vlerës nga ajo që tashmë di? Pak prej nesh duan të plaken para kohe; po aq pak duan të jenë adoleshentë në moshën 90-vjeçare. “Përsëritja e rregullave dhe ritualeve, rregullave dhe ritualeve, ka efekte shkatërruese mbi mendjet tona”, insiston Zmigrod. “Me çdo përsëritje dhe veprim mekanik, forcohen rrugët nervore që mbështesin shprehitë tona, ndërsa lidhjet alternative mendore – më origjinale, por më pak të praktikuara – priren të zbehen”. Unë e shoh këtë si një përshkrim të procesit të të nxënës; Zmigrod e sheh si një rrëshqitje drejt ekstremizmit. Mund ta shihni botën në atë mënyrë, nëse doni, por nuk më duket se do t’ju çojë shumë larg. /Telegrafi/



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Kosova U17 fiton ndaj Moldavisë

PRISHTINË, 10 MARS - Përfaqësuesja e Kosovës U17 në futboll ka shënuar fitore në ndeshjen e dytë në kuadër të Grupit B4 në raundin e dytë kualifikues të Ligës B për Kampionatin Evropian

2025. Pas barazimit pa gola ndaj Andorrës, “dardanët” e rinj të udhëhequr nga përzgjedhësi Arbnor Morina arritën ta mposhtin Moldavinë, me rezultat të ngushtë 1:0. Golin e vetëm

në këtë ndeshje e realizoi Rin Ahmeti në minutën e 41-të. Edhe në ndeshjen e sotme Kosova mbizotëroi në lojë dhe pati më shumë iniciativë drejt portës kundërshtare, teksa edhe moldavët patën

një mundësi të mirë shënimi, por nuk arritën ta konkretizojnë me gol. Pas ndeshjes, Morina u shpreh i kënaqur me paraqitjen e ekipit. Ndeshjen e fundit në këtë fazë, Kosova e zhvillon



kundër Qipros, nikoqire, më 13 mars.

Sot derbi Drita - Ballkani



“Epoka e re”

PRISHTINË, 10 MARS - Sot (e martë) zhvillohet derbi i dy skuadrave favorite për titull në elitën e futbollit të Kosovës, Dritës dhe Ballkanit. Skuadra lidere e Superligës, Drita, në fundjavë pësoi humbje nga Llapi dhe tash do të përpiqet t’u rikthehet rezultateve pozitive, pasi edhe me një tjetër dështim mund të zvogëlohet edhe me shumë dallimi i pikëve me kampionët në fuqi. Në anën tjetër, Ballkani, që është dhjetë pikë

pas skuadrës liderë, barazoi në fundjavë me Prishtinën (1-1), e tash e ka mundësinë të tregohet skuadër e fortë dhe triumfoi ndaj rivalëve direktë për titull dhe të ngushtojë dallimin e pikëve. Ferizaj e pret sot skuadrën e Llapi. Edhe kjo ndeshje zhvillohet ditën e martë. Të dyja këto klube në ndeshjet e fundit kanë shënuar fitore dhe do të mundohen ta vazhdojnë këtë seri pozitive. Të mërkurën do të zhvillohet edhe një tjetër ndeshje interesante mes Malishevës dhe Gjilanit, kurse do të ballafaqohen edhe Prishtina dhe Dukagjini. Kjo

xhiro përfundon të enjten me ndeshjen Suhareka - Feronikeli.

SUPERLIGA

Të martën takohen:
14:00 Drita - Ballkani
14:00 Ferizaj - Llapi

Të mërkurën takohen:
12:30 Prishtina - Dukagjini
14:00 Malisheva - Gjilani

Të enjten takohen:
14:00 Suhareka - Feronikeli

Sonte mësohen katër çerekfinalistët e parë

“Epoka e re”

LIVERPOOL, 10 MARS - Sonte zhvillohen ndeshjet kthyesë në katër përballjet e Ligës së Kampionëve për 1/8 e finales, ku edhe do të mësohen katër skuadrat e para që kualifikohen në çerekfinale. Vëmendja kryesore është në ndeshjen në mes të Liverpoolit dhe PSG-së. Në ndeshjen e parë fituan anglezët me rezultat 0-1, por ajo ndeshje ishte dominuar plotësisht nga francezët të cilët assesi nuk arritën të shënonin në portën e

Alissonit, i cili pati ndeshjen më të mirë në karrierë. Tash kampionët e Francës kanë synim që në Angli ta përmbysin rezultatin dhe të kualifikohen në çerekfinale, por “Reds” nuk do të dorëzohet lehtë pasi synon të jetë i suksesshëm si në Premierë Ligë ashtu edhe në Ligën e Kampionëve. Në ndeshjen tjetër Bayern Munchen do të ketë punë më të lehtë për ta arritur kualifikimin në çerekfinale, pasi e mposhti Bayer Leverkusenin në ndeshjen e parë me rezultat 3-0. Shokët e Granit Xhakës nuk

janë dorëzuar ende dhe synojnë t’i befasojnë rivalët gjermanë. Interi e pret Feynoordin dhe është në avantazh prej dy golash nga ndeshja e parë, derisa në ndeshjen tjetër Barcelona takohet me Benficën. Përballja e parë në Portugali kishte përfunduar me rezultat 0-1.

TË MËRKURËN TAKOHEN:

18:45 Barcelona - Benfica (1-0)
21:00 Leverkusen - Bayern (0-3)
21:00 Inter - Feynoord (2-0)
21:00 Barcelona - Benfica (1-0)



Nesbitt, MVP i javës në Superligë



SUHAREKË, 10 MARS - ProCredit Superliga ka hyrë në fazën vendimtare, ku çdo ndeshje është shumë e rëndësishme. Golden Eagle Ylli shënoi fitore shumë të vlefshme ndaj Trepçës, e më i dalluari ishte i rikthyeri te therandasit, Jalen

Nesbitt, me 16 pikë, gjashtë kërcime dhe dy asistime. Ai kishte indeksin 27, apo më të lartin nga skuadrat fituese. Bashkimi fitoi në Gjakovë ndaj Vëllaznimit. Te prizrenasit u dalluan Wendell Green me 18 pikë, dy kërcime dhe gjashtë

asistime, si dhe Lejson Zeqiri me 17 pikë, pesë kërcime dhe një asistim. Peja fitoi në duelin e zhvilluar në Prizren ndaj Proton Cable Prizrenit, ku te verdhezinjtë më i miri ishte Dardan Berisha me 19 pikë, gjashtë kërcime dhe dy

asistime. Sigal Prishtina regjistroi fitoren e nëntë radhazi në elitën e basketbollit, duke fituar ndaj Borës, ku më i miri te bardhekaltrit ishte Josh Nzeakor me 16 pikë, nëntë kërcime dhe një asistim.

Kosova fillon përgatitjet për ndeshjen vendimtare me Ukrainën

PRISHTINË, 10 MARS - Me mendje te ndeshja e së enjtes me Ukrainën, ka nisur të dielën grumbullimi i Kombëtares A të Kosovës në hendboll. Nën urdhrat e selektorit Bujar Qerimi në

stërvitjen e mbrëmjes ishin shumica e lojtarëve, ndërsa grupi pritet të kompletohet të hënën. Stërvitja nuk ishte me ngarkesë të madhe për shkak të angazhimit të të gjithë lojtarëve në ditët e kaluara. Tri

ditët e ardhshme do të shfrytëzohen maksimalisht që të enjten nga ora 20:15, Kosova të jetë në formën më të mirë të mundshme. Ndeshja me Ukrainën zhvillohet në Pallatin e Rinisë dhe Sportit në

Prishtinë, kurse djemtë dardanë presin përkrahje të madhe nga tribunat për ta realizuar së bashku synimin e madh. Ndeshja i takon fazës së dytë të kualifikimeve për “Euro 2026”.



Clevelandi dhe Oklahoma nuk njohin rivalë në NBA

OKLAHOMA, 10 MARS - Skuadra e Clevelandit vijon të komandojë në Lindje, duke mposhtur me rezultat 112-100 Milwaukee jashtë fushës. Të gjithë titullarët e Cavaliersit realizuan mbi 10 pikë, duke i bërë të pavlefshme 30 pikët e

Antetokounmpos për Bucksin. Të njëjtin ritëm ndjek edhe Oklahoma në Perëndim, që mundi me rezultat 127-103 Denverin, duke mbrojtur kreun. Alexander Shai me 40 pikë ishte lider për Thunderin, mbështetur edhe nga Jalen

Williams me 26 pikë. Në kohën shtesë fiton Clippersin, 111-110 ndaj Sacramentos, ndeshje ku u dallua James Hardeni me 29 pikë. Skuadra e Minnesotas, falë një loje të mirë kolektive (8 lojtarë realizuan mbi 10 pikë), mundi me shifrat 141-124 San

Antonio. Rezultatet: Oklahoma-Denver (127-103), Dallas-Phoenix (116-125), New Orleans-Memphis (104-107), Philadelphia-Utah Jazz (126-122), Milwaukee-Cleveland (100-112), Minnesota-San Antonio (141-124).



Angli - Shqipëri, tifozët shqiptarë do të jenë në çdo cep të stadiumit 'Wembley'

TIRANË, 10 MARS - Në prag të përballjes mes Anglisë dhe Shqipërisë, që do të zhvillohet më 21 mars për kualifikueset e Kupës së Botës, gazetari Fatjon Baze zbuloi në një lidhje direkte nga Wembley për emisionin "Max Sport" në "Euronews Albania", informacione të vlefshme për këtë sfidë. Baze theksoi se sfida e ardhshme ndaj Shqipërisë do të ketë një vëmendje të veçantë për tifozët anglezë, për një arsye të rëndësishme: debutimin e trajnerit të ri të "Tre Luanëve", Thomas Tuchel.

Ky moment ka shkaktuar një interes të madh te tifozët për shkak se duan t'i shohin ndryshimet në mënyrën e lojës të trajnerit të ri. "Interesi për këtë ndeshje është jashtëzakonisht i madh jo vetëm nga tifozët, por edhe nga shtypi sportiv. Anglia e sheh këtë ndeshje me Shqipërinë si mundësinë ideale për ta nisur ciklin kualifikues me këmbën e mbarë dhe për të siguruar tri



pikë të rëndësishme", ka shpjeguar Baze. Tifozët dhe drejtuesit e Federatës angleze shpresojnë që ai të sjellë një frymë të re dhe një identitet të ndryshëm për Kombëtaren. "Pritet që Tuchel të sjellë një stil të ri loje dhe t'i ngrejë pritshmëritë për sukseset e ardhshme të Anglisë," shtoi Baze. Një tjetër aspekt që do të jetë në vëmendje është lista e lojtarëve që Tuchel do të përzgjedhë për këtë ndeshje dhe për sfidën e ardhshme ndaj Letonisë. "Pritet

të shohim se si do t'i përzgjedhë Tuchel lojtarët. Ai ka krijuar një listë të zgjeruar me 55 futbollistë, dhe megjithëse janë përhapur shumë spekulime, Tuchel ka qëndruar në Angli për t'i ndjekur ndeshjet dhe për të komunikuar me lojtarët", theksoi gazetari. Po ashtu, Baze theksoi se tifozët shqiptarë do të jenë të pranishëm në çdo sektor të stadiumit të Wembly, duke krijuar një atmosferë elektrizuese. "Stadiumi është plot, dhe tifozët shqiptarë kanë siguruar një numër të konsiderueshëm biletash. Ata do të jenë të pranishëm në çdo cep të stadiumit, duke valëvitur flamujt shqiptarë dhe duke krijuar një atmosferë fantastike. Pavarësisht prej diferencave të mundshme në fushë, atmosfera në shkallët do të jetë e jashtëzakonshme. Tifozët shqiptarë janë të organizuar dhe gati për të krijuar një ambient që do të mbetet në kujtesën e të gjithëve", ka përfunduar Baze.

Kenan Haxhihamza për herë të dytë rrëmben çmimin 'Ylli i javës'

"Epoka e re"

GJILAN, 10 JANAR - Federata e Futbollit e Kosovës dhe sponsori i Superligës, Albi Mall, vazhdojnë ta japin çmimin "Ylli i javës". Ky çmim për javën e 23-të në Albi Mall Superligë i është dhënë për herë të dytë portierit të SC Gjilanit, Kenan Haxhihamza. Vlerësimi i më të mirit të javës është bërë nga Komisioni i Veteranëve të Futbollit, në përbërje të Bujar Guta, Milaim Humolli dhe Fatmir Mehmeti. Ky komision vendosi që çmimi "Ylli i Javës" për xhiron e 23-të t'i takojë Kenan Haxhihamzës, i cili, me pritjet e tij gjatë tërë ndeshjes dhe me penaltinë që arriti ta mbrojë në minutat shtesë, ishte më meritor në fitoren e SC Gjilanit kundër FC Feronikelit 74, e cila



përfundoi me rezultat minimal 1:0. Pasi mori këtë çmim, Haxhihamza u shpreh i lumtur që u vlerësua më i miri i javës: "Momenti ka qenë pak interesant, sepse fillimisht nuk e kam pritur që do të akordohet penallti. Nuk e kisha të qartë

situatën, por më pas gjithçka shkoi në favorin tim. Arrita ta pritja atë penallti, që ishte vendimtare për ekipin, dhe në fund arkëtuam tri pikë shumë të nevojshme. Ambiciet tona janë të qarta, të vazhdojmë këtë formë të mirë dhe të synojmë Evropën". "Ky është edhe objektivi i klubit dhe shpresojmë ta arrijmë. Gjithmonë çmimet të motivojnë për më shumë. Përdorja e kam fituar dy herë, pse të mos tentoj ta marr edhe për herë të tretë? Gjithçka ka ndodhur falë punës ekipore dhe shpirtit luftarak që kemi treguar në fushë. Shpresojmë të vazhdojmë kështu. Me këtë rast dua t'i uroj të gjithë ata që agjërojnë në këtë muaj të shenjtë. Zoti i begatofitë dhe i shpërbleftë për këtë agjërim!", ka deklaruar Haxhihamza për faqen zyrtare të FFK-së.

SHKURT

Bero Kingdom triumfon në Prizren

Qyteti i Prizrenit ishte destinacioni i radhës, ku është mbajtur turneu i Alley Oop në 3x3. Në turneun e zhvilluar në Prizren kanë marrë pjesë gjashtë ekiye. Fillimisht janë zhvilluar ndeshjet në grupe, më pas janë zhvilluar gjysmëfinale dhe finalja, ku janë përballur Bero Kingdom dhe djemtë e Prizrenit. Pas një loje interesante, Bero Kingdom shënoi fitore, duke triumfuar në Prizren, për ta siguruar biletën për finalen e madhe në Prishtinë. Skuadra fituese mori shpërblimin prej 300 euro.

Ky ishte turneu i tretë i Alley Oop, pas Prishtinës dhe Gjakovës, derisa do të vazhdojë edhe në Pejë, Mitrovicë dhe Therandë. Skuadrat finaliste do të ndeshen në Prishtinë për fituesin e parë të edicionit të parë. Ky projekt është në partneritet me FIBA Evropën, derisa qëllimi është ta masivizojë basketbollin 3x3 në të gjithë Kosovën.

Leclerc: U bëmë një premtim tifozëve dhe duam ta mbajmë fjalën

Pritja e gjatë po mbaron. Këtë fundjavë rikthehet botërori i Formulës 1, ku në pistën e Melburnit do të zhvillohet gara e Çmimit të Madh të Australisë. Të gjithë presin me padurim të shohin se si do të shkojnë gjërat, veçanërisht te Ferrari, një makinë me shumë risi këtë sezon. Piloti monegask Charles Leclerc u shpreh: "Objektivi përfundimtar mbetet të sjellim titullin në shtëpi. Nuk kam asnjë dyshim për pritshmëritë tona. Sezoni i kaluar tregoi se mund t'ia dalim mbanë dhe se duhet ta nisim që në fillim me këmbën e mbarë për të mos humbur pikë". "Testet dhanë një panoramë, por do të jetë gara ajo që do të tregojë realisht se ku janë makinat. Mendoj se jemi shumë pranë njëri-tjetrit, ndaj duhet kujdes që të përfitojmë nga çdo mundësi. U premtuam diçka atyre tifozëve në Milano dhe duam ta mbajmë fjalën", ka thënë Leclerc.

Williams: Nuk jam penduar se e refuzova Barcelonën

Ylli i Athletic Bilbaos, Nico Williams, nuk është penduar se e refuzoi Barcelonën verën e kaluar. Repreruesi spanjoll ishte objektivi kryesor i Barcelonës pas përfundimit të "Euro 2024". Interesimi i Barcelonës në vitin 2025 po vazhdon të ftohet me raportimet e fundit që bëjnë me dije se Arsenali është i gatshëm ta aktivizojë klauzolën e tij të lirimit prej 58 milionë eurosh. Sulmuesi foli edhe një herë tjetër për këto thashetheme duke deklaruar se nuk është penduar për vendimin që mori. "Në atë moment verën e kaluar, e mora vendimin që e konsideroja të ishte i duhuri dhe jam shumë i lumtur me të. Ishte për familjen time. Raporti që kam me këtë klub është i jashtëzakonshëm dhe nuk besoj se do ta gjeja këtë atmosferë diku tjetër", ka thënë Williamsi.

Dembele mund të largohet nga PSG-ja

Ousmane Dembele po shijon sezonin më të mirë të karrierës së tij nën drejtimin e Luis Enrique në Paris Saint-Germain. Me 20 gola dhe 5 asistime në Ligën 1 dhe 6 gola në Ligën e Kampionëve, ai

është bërë një nga yjet më të mëdha në Evropë këtë sezon. Megjithatë, e ardhmja e tij në PSG është e pasigurt. Sipas "El Nacional", burime pranë lojtarit sugjerojnë se një ofertë fitimprurëse nga Arabia Saudite

mund ta tundojë atë të lëvizë këtë verë, me raportet për një marrëveshje prej 100 milionë eurosh për sezon, një ofertë e vështirë për t'u refuzuar. Që nga bashkimi me PSG-në, Dembele ka treguar përmirësim të

ndjeshëm në vendimmarrje dhe qëndrueshmëri, duke u bërë një figurë kyçe në sistemin sulmues të Luis Enrique. Pavarësisht se PSG-ja e vlerëson shumë atë, fuqia financiare e klubeve saudite

mund ta ndryshojë situatën. Në moshën 27-vjeçare Dembele përballlet me dilemën nëse duhet t'i japë përparësi karrierës së tij evropiane apo të pranojë një kontratë që t'ia ndryshojë jetën.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCES DHE TEKNOLOGJISË
AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRITUR
AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Numër: 502 /1
Datë: 10.03.2025

Agjencia e Arsimit dhe Aftësimi Profesional dhe Arsimit për të Rritur (AAAPARr), në bazë të nenit 13 dhe 34 të Ligjit të Arsimit dhe Aftësimi Profesional (Gaz. Zyrtare e Republikës se Kosovës nr. 7/26 Mars),në bazë të Ligjit Nr. 04/l-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, Udhëzimit Administrativ nr. 05/2012, Udhëzimit Administrativ nr. 14/2014, Udhëzimit Administrativ nr. 02/2016, si dhe në bazë të kërkesës së shkollës Qendra e Kompetencës “Kujtim Krasniqi” në Malishevë shpall:

Ftesë për ofertë

Për ekskursion të maturantëve të Qendra e Kompetencës “Kujtim Krasniqi” në Malishevë, në Republikën e Shqipërisë.

Ftojmë ofertuesit e kualifikuar (Agjensionet turistike organizatore të udhëtimit) që të paraqesin ofertat e tyre në zarf të mbyllur.

Agjensioni turistik duhet t’i plotësojë këto parakushte:

- Regjistrimi në regjistrin profesional të ndërmarrjeve (Certifikata e biznesit).
- Të jetë i licencuar sipas procedurave ligjore.
- Dëshmia e kontrollit teknik të automjetit sipas procedurave ligjore, dhe të ketë numër të mjaftueshëm të autobusëve për nevojat e shkollës.
- Autobusët të jenë komfort dhe me klimë.
- Agjencioni duhet të ketë dëshmi për shëndetin fizik dhe mendor të ngasësve të autobusit.
- Agjencioni duhet të ketë të pajisur shoferët me kompetencën profesionale (CPC)
- Certifikata e autobusit sipas Licencës “D”;
- Agjencioni duhet të sigurojë përkujdesje mjekësore për nxënës dhe dëshmi (Certifikatë pune dhe diplomë të mjekut) që shoqëron nxënësit;
- Lloji i transportit (Autobus);
- Agjensioni duhet të ketë një parakontratë për rezervimin e hotelit me data të caktuara nga KDSH-ja në Hotel “Bonita”, në Durrës (prej 04 deri 08 Prill 2025).
- Agjencioni turistik duhet t’i përmbahet itinerarit të cilin e ka përcaktuar Këshilli Drejtues i shkollës.
- Agjencioni duhet të ofrojë një listë me emrat e shoferëve që do të marrin pjesë në ekskursion, kategorinë e patentë shoferit, llojin e autobusit, vitin e prodhimit, numrin e ulëseve dhe targat e autobusit që do të vozisin.
- Agjencioni duhet të posedojë referencat nga organizimet e llojit të njëjtë në të kaluarën.
- Te gjitha dokumentet e kërkuara duhet të jenë origjinale ose fotokopje te vërtetuara!

Kushtet tjera:

- Nisja duhet të bëhet më dt. 04.04.2025 dhe kthimi më dt. 08.04.2025.
- *Të sigurohet pansioni i plotë. Gjatë udhëtimeve nëpër qytete racioni i rregullt mund të zëvendësohet me ushqim të thatë.*
- *Në të shkuar, gjatë rrugës ushqim çasti të mëngjesit dhe pije, ndërsa darkën në Durrës. Në të kthyer darkë cilësore dhe në kohë normale.*
- *Hoteli të posedojë sallë për ballo*
- *Agjencioni të merr përsipër pagesën e vizitave monumenteve kulturo historike*
- *Të ketë komoditet gjatë udhëtimit (autobusë me kondicioner).*
- *Mundësi vizite në qytetet: Krujë, Tiranë, Durrësi i vjetër,Berat, Vlorë.*

Vlerësimi i ofertave:

Hapja e ofertave bëhet nga komisioni sipas UA 02/2016 në ambientet e Agjencinë AAAPARr-së në Prishtinë. Kriter për përzgjedhjen e kompanisë turistike do të jetë oferta më e përshtatshme ekonomike:

- Çmimi i ofertës
- Lloji i Hotelit (kategoria, nr. i nxënësve nëpër dhoma etj)
- Menyja
- Gjendja teknike e autobusëve dhe numri
- Numri i referencave

Pas vlerësimit të ofertave nga komisioni, publikimi i përfutësit do të shpallet pasdite në tabelën e shpalljeve në AAAPARr në të njëjtën ditë. Ofertuesit e interesuar ofertat e kompletuara me dokumentacionin e kërkuara ti dorëzojnë në Agjencinë e AAAPARr-së në Prishtinë rruga “Agim Ramanadani” ndërtesa MASHT II kati i tretë, gjatë orarit 08:00-14:00. Hapjen e ofertave e bënë Komisioni sipas Udhëzimit Administrativ nr.02/2016. Përparësi në shqyrtimin e ofertave nga ana e komisionit do të kenë Agjencionet turistike që e kanë të kompletuar ofertën dhe që i plotëson kriteret e caktuara nga KDSH-ja. Agjencia e Arsimit dhe Aftësimi Profesionale dhe Arsimit për të Rritur mban të drejtën për anulimin e ofertës. Vlerësimi i ofertave do të bëhet në ditën e mbylljes së shpalljes së ofertës pas orës 14:00. Data e nisjes mund të ndryshojë (plus-minus një ditë) , ndërsa agjenda mund të ndërrojë varësisht nga kërkesa e udhëheqësit të ekskursionit. Vërejtje: Secili ofertues duhet të aplikojë vetëm me një ofertë.

Afati i paraqitjes se ofertave është shtatë (7) ditë nga dita e shpalljes në gazetën ditore, hapja dhe vlerësimi i ofertave bëhet po atë ditë në zyrën Qendrore të Agjencisë së Arsimit dhe Aftësimi Profesionale dhe Arsimit për të Rritur.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Grey Fiks” SH.P.K. me seli në Mitrovicë, pronar Enis Ahmeti, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 812024652 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Grey Fiks” D.O.O. Mitrovica, Enis Ahmeti donelo odluku o prestani rada sa nrb. 812024652 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Grey Fiks” L.L.C. Enis Ahmeti with headquarters Mitrovicë, has come to the decision to quit its business: 812024652 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, Kompania “Dervis Bey” Sh.p.k. Mamushë në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për pompën e derivateve në Mamushë.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 25.04.2025 në ora 11:00 në Sallën e kuvendit komunal të Mamushës do të organizohet debat publik nga Kompania “Dervis Bey” Sh.p.k. Mamushë në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën elektronike

<https://us04web.zoom.us/j/3551128793?pwd=b252S1MvQmphd1o3bW8vcxkdV09QT09>

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Kompaninë “Dervis Bey” Sh.p.k. Mamushë për pompën e derivateve në Mamushë.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin vnm.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Mitrovicës
Opština Mitrovica – Municipality of Mitrovica
NPL - "Qendra Multifunkionale" SH.A.



Në bazë të Ligjit Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, dhe të gjitha aktet tjera ligjore për ndryshim plotësimet e këtij ligji, si dhe bazuar në nenin 8 të Ligjit nr. 03/L-212 të Punës, nenit 5 të Udhëzimit Administrativ nr. 01/2024 për Rregullimin e Procedurave për Themelimin e Marrëdhënies së Punës në Sektorin Publik, "Ndërmarrja Publike "Qendra Multifunkionale" SHA shpall:

K O N K U R S

KONKURS PUBLIKË PËR VENDE PUNE

Titulli i pozitës:

-Përgjegjës për palestër sportive (1)

Entiteti: NPL "Qendra Multifunkionale" SH.A

Vendi:Mitrovicë

Afati për aplikim (15) ditë nga data 11.03.2025 deri më 26.03.2025

Përshkrim

NPL "Qendra Multifunkionale" SHA-Mitrovicë, është Ndërmarrje Publike Lokale në pronësi me 100% të aksioneve të saj nga Komuna e Mitrovicës. Të ardhurat e mëdha të kësaj Ndërmarrje gjenerohen nga aktivitetet e hyrje-daljeve të Ndërmarrjes. NPL "Qendra Multifunkionale" SH.A. është në kërkim të stafit mbështetës në Palestrën Sportive të Ndërmarrjes me kualifikim, me integritet të njohurive, përvojë të nevojshme profesionale që do të kujdesen në ndërmarrje në përputhje me parimet e njohura profesionale.

Vendi i punës: Përgjegjës për palestër sportive nr.reference 01/2025

- ◊ Diplomë e nivelit Bachelor, drejtimi Kulturë Fizike dhe Sport;
- ◊ Përvojë në lëminë e kërkuar, minimumi 3 vite;
- ◊ Përparësi kanë personat që kanë trajnim-çertifikatë në fushën e sportit.
- ◊ Aftësi të mira komunikuese;
- ◊ Të jetë i gatshëm të punoj vetëm dhe me ekip;
- ◊ Nivel të lartë të etikës profesionale
- ◊ Të punojë në orar fleksibil dhe të jetë i aftë të punojë nën presion.

Përgjegjësitë kryesore janë:

- ◊ Koordinon orarin e termineve për Palestrat dhe Sallën Sportive;
- ◊ Ofron shërbime si trajner sportiv, mban trajnime me fëmijë, këshillon në fushat përkatëse sportive;
- ◊ Mirëmban rregullisht hapësirat kryesore të Palestrave, Sallës si dhe hapësirave të tjera ndihmëse;
- ◊ Bashkëpunon me shkollat për caktimin e termineve;
- ◊ Mban evidencën e të gjitha termineve të mbajtura;
- ◊ Ofron shërbim të shkëlqyeshëm ndaj klientëve me qëllim të krijimit të një ambienti të hapur dhe miqësor;
- ◊ Raporton tek udhëheqësit;
- ◊ Si dhe angazhohet në shërbime të tjera sipas kërkesës së mbikeqyrësit në përputhje me natyrën e punës.
- ◊ Për punën e vetë i përgjigjet Ligjit, Udhëheqësit të tij, Kryeshefit Ekzekutiv.

Procedura e aplikimit:

- Aplikacioni për punë
- CV-ja
- Dëshmia mbi përgaditjen profesionale
- Çertifikata e lindjes (origjinal)
- Letërnjoftimi (kopje)
- Përvoja e punës nga lëmia profesionale(për pozitën që nevojiten)
- Vërtetimi se nuk jeni nën hetime jo më të vjetër se (6) gjashtë muaj.

Vërejtje: I gjithë dokumentacioni merret në Administratën e NPL "Qendrës Multifunkionale"SH.A, si dhe duhet të dorëzohet i mbyllur në zarf.

Dokumentet e dorëzuara nuk kthehen.

Vetëm kandidatët të cilët hyjnë në listën e ngushtë do të kontaktohen dhe ftohen për intervistë.

Muhamet Sylejmani

Kryeshef Ekzekutiv





Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Mitrovicës
Opština Mitrovica – Municipality of Mitrovica
NPL - "Qendra Multifunkionale" SH.A.



Na osnovu Zakona br. 03/L-087 o javnim preduzećima, i svih drugih zakonskih akata koji menjaju ovaj zakon, kao i na osnovu člana 8. Zakona br. 03/L-212 Administrativnog uputstva br.5 01/2024 o regulisanju procedura za uspostavljanje radnih odnosa u sektoru javnih preduzeća, „P” SHA najavljuje:

K O N K U R S

JAVNI KONKURS ZA RADNA MJESTA

Naziv pozicije:

-Odgovoran za sportsku teretanu (1)

Subjekt: NPL "Multifunkcionalni centar" dd

Mesto: Mitrovica

Rok za prijavu (15) dana od 11.03.2025. do 26.03.2025.

Opis

NPL "Multifunkcionalni centar" SHA-Mitrovica, je lokalno javno preduzeće u vlasništvu Opštine Mitrovica sa 100% akcija. Najveći prihod ovog preduzeća je generisan od aktivnosti ulaza i izlaza preduzeća. NPL "Multifunkcionalni centar" dd. traži pomoćno osoblje u Sportskoj teretani Preduzeća sa kvalifikacijama, sa integritetom znanja, neophodnim profesionalnim iskustvom o kojima će se brinuti u preduzeću u skladu sa priznatim profesionalnim principima.

Posao: Šef sportske teretane referencia br 01/2025

- ◻ Diploma fizičke kulture i sporta;
- ◻ Iskustvo u traženoj oblasti, minimalno 3 godina;
- ◻ Prednost imaju lica koja imaju sertifikat o obuci, u oblasti sporta.
- ◻ Dobre komunikacijske vještine;
- ◻ Budite spremni da radite sami i sa timom;
- ◻ Visok nivo profesionalne etike
- ◻ Radite fleksibilno i možete raditi pod pritiskom.

Glavne odgovornosti su:

- ◻ Uskladuje raspored termina za teretane i sportsku dvoranu;
- ◻ Pruža usluge sportskog trenera, održava treninge sa djecom, savjetuje u relevantnim sportskim oblastima;
- ◻ Redovno održava glavne prostore teretane, salu kao i druge pomoćne prostore;
- ◻ Sarađuje sa školama na određivanju rokova;
- ◻ Vodi evidenciju o svim održanim terminima;
- ◻ Pruža odličnu uslugu korisnicima u cilju stvaranja otvorenog i prijateljskog okruženja;
- ◻ Izvještava lidere;
- ◻ Kao i angazovanje u drugim uslugama koje zahteva nadzornik u skladu sa prirodom posla.
- ◻ Za svoj rad odgovara zakonu, svom rukovodiocu, glavnom izvršnom direktoru.

Postupak prijave:

- Prijava za posao
- CV
- Dokaz o stručnoj obuci
- Izvod iz matične knjige rođenih (original)
- Pismo obavještenja (kopija)
- Radno iskustvo iz stručne oblasti (za tražene pozicije)
- Dokaz da niste pod istragom ne stariji od (6) šest mjeseci.

Napomena: Sva dokumentacija se prima u Upravi NPL "Multifunkcionalni centar" SH.A, i mora se dostaviti zatvorena u koverti.

Dostavljeni dokumenti se ne vraćaju.

Samo kandidati koji uđu u uži izbor bit će kontaktirani i pozvani na intervju.

Muhamet Sylejmani

Glavni izvršni direktor





SHPALLJE E VENDIT TË LIRË TË PUNËS

Titulli i vendit të punës: Zyrtar/e i/e lartë për prokurim dhe kontraktim
Grada: D09
Kohëzgjatja e punësimit: me afat të pacaktuar
Divizioni: Divizioni i Prokurimit dhe Kontraktimi
I raporton: Udhëheqësit të Divizionit

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Zbaton Rregullën për procedurat e prokurimit dhe ato të kontraktimit siç aplikohen në BQK.
- Përgatit dokumentacionin për prokurim (dosjet e tenderit, procesverbalet, njoftimet për kontratë, kontratat e prokurimi dhe njoftimet e tjera, formularët, etj.) sipas udhëzimeve që jepen në Rregull dhe sipas kushteve të tenderit.
- Mirëmban dokumentacionin për secilën procedurë dhe mban evidencë për tërë proceset e prokurimeve në mënyrë të plotë dhe të saktë kronologjike.
- Harton kontratat e prokurimit në harmoni me Rregullën e prokurimit dhe në përputhje me kushtet e tenderit.
- Propozon kushte të veçanta për kontratat e prokurimit sipas natyrës së prokurimit dhe në përputhje me standardet më të mira ndërkombëtare të prokurimit.
- Monitoron implementimin e kontratave sipas kushteve të caktuara dhe ofron opinion profesional rreth zgjidhjes së mosmarrëveshjeve.
- Propozon forma dhe përmbajtje adekuate të kontratave të prokurimit sipas zhvillimeve të reja brenda vendit dhe atyre ndërkombëtare.
- Përgatit dokumentacionin e nevojshëm të prokurimit për publikim, si: njoftimet për kontratë, njoftimet për dhënie të kontratës, etj. dhe koordinon afatet kohore të aplikueshme në harmoni me Rregullën e prokurimit.
- Kujdeset për organizimin dhe menaxhimin e seancave të hapjes publike të ofertave, mbajtjen e procesverbaleve dhe përgatitjen e dokumenteve tjera përcjellëse.
- Kujdeset për komunikim korrekt, të saktë dhe zyrtar me palët e jashtme – operatorët ekonomik si edhe me palët brenda BQK-së.
- Merr pjesë dhe asiston komisionet në seancat e hapjes së ofertave, pastaj asiston komisionet gjatë proceseve të vlerësimit të ofertave sipas procedurave përkatëse.
- Përgatit raporte të rregullta periodike (javore, mujore, e vjetore) për aktivitetet e prokurimit.
- Sipas kërkesave dhe udhëzimeve të mbikëqyrësit direkt kryen edhe detyra të tjera që lidhen me procedurat dhe proceset e prokurimit dhe kontraktimit.

Njohuritë akademike dhe profesionale të kërkuara:

- Diplomë universitare në fushën e drejtësisë apo fushat tjera të cilat ndërlidhen me përgjegjësitë e njësisë organizative.
- Certifikim profesional në fushën e prokurimit është përparësi.
- Njohja e gjuhës angleze është përparësi.

Përvoja profesionale e kërkuar:

- Së paku dy (2) vite përvojë pune që ndërlidhet me fushën e prokurimit.

Kërkesat e posaçme:

- Aftësi komunikuese në të shkruar si dhe aftësi për zgjidhjen e problemeve sipas prioriteteve.
- Aftësi të shkëlqyera kuantitative dhe analitike.
- Njohuri të shkëlqyera në përdorimin e sistemeve kompjuterike, MS Office e të ngjashme.
- Person me etikë të lartë dhe i aftë në ruajtjen e fshehtësisë profesionale.
- Vëmendje në detaje, në formulime të qarta dhe saktësi.
- Vetiniciativë dhe gatishmëri për punë ekipore.

Të gjithë kandidatët duhet të dërgojnë dokumentet e mëposhtme:

- Formularin zyrtar të BQK-së për aplikim;
- Letrën përcjellëse (motivuese) ku theksohet interesimi për këtë pozitë;
- **Dëshmi mbi përvojën e punës** (kopjet e kontratave ose vërtetimeve nga punëdhënësi ose dokumente tjera relevante që shërbejnë për të dëshmuar pozitën e mbajtur dhe përvojën e punës, pa cenuar aktet relevante për mbrojtjen e të dhënave personale);
- **Raportin nga Fondi për Kursime Pensionale i Kosovës (Trusti)** për periudhën përkatëse, apo vërtetimin tatimor nga Administrata e Tatimore (ATK) kur raporti nga Trusti nuk aplikohet ligjërisht;
- Kopjet e diplomave, ndërsa diplomat e fituara jashtë Republikës së Kosovës duhet të jenë të njohura /nostrifikuara zyrtarisht nga ana e MASHT-it;
- Dëshmi mbi identitetin/kopja e letërnjoftimit që shërben për të vërtetuar shtetësinë e Kosovës.

Procedura e aplikimit:

- Afati i fundit për aplikim është **26 mars 2025**.
- Aplikimi mund të bëhet online (<https://hris.bqk-kos.org>) përmes faqes zyrtare të BQK-së ose përmes arkivit të BQK-së. Format tjera të aplikimit nuk do të merren parasysh.
- Formën e aplikacionit mund ta shkarkoni përmes faqes zyrtare: www.bqk-kos.org



RASPISIVANJE KONKURSA ZA SLOBODNO RADNO MESTO

Naziv radnog mesta: Viši službenik za nabavke i ugovaranja
Rang: D09
Trajanje radnog odnosa: Na neodređeno vreme
Odeljenje: Odeljenje za nabavke i ugovaranja
Izveštava : Šefa divizije

Dužnosti i odgovornosti:

- Sprovodi Pravilo o procedurama nabavke i ugovaranja kako se primenjuje u CBK.
- Priprema dokumentaciju o nabavkama (tenderske dosijee, zapisnike, obaveštenja o ugovorima, ugovore o nabavkama i druga obaveštenja, obrasce i sl.) prema uputstvima datim u Pravilu i prema uslovima tendera.
- Vodi dokumentaciju za svaki postupak i vodi evidenciju o svim procesima nabavki na potpun i tačan hronološki način.
- Izrađuje ugovore o nabavkama u skladu sa Pravilom o nabavkama iu skladu sa uslovima tendera.
- Predlaže posebne uslove za ugovore o nabavkama prema prirodi nabavke iu skladu sa najboljim međunarodnim standardima nabavke.
- Prati sprovođenje ugovora prema određenim uslovima i daje stručno mišljenje o rešavanju sporova.
- Predlaže adekvatne oblike i sadržaj ugovora o nabavkama prema novim dešavanjima u zemlji i inostranstvu.
- Priprema neophodnu dokumentaciju o nabavkama za objavljivanje, kao što su: obaveštenja o ugovoru, obaveštenja o dodeli ugovora itd. i koordinira primenljive rokove u skladu sa Pravilom nabavke.
- Brine se o organizaciji i vođenju sednica javnog otvaranja ponuda, vođenju zapisnika i pripremi druge prateće dokumentacije.
- Vodi računa o pravičnoj, tačnoj i zvaničnoj komunikaciji sa spoljnim stranama – ekonomskim operaterima, kao i sa strankama unutar CBK-a.
- Učestvuje i pomaže komisijama na sednicama otvaranja ponuda, zatim pomaže komisijama tokom procesa procene ponuda u skladu sa relevantnim procedurama.
- Priprema redovne periodične izveštaje (nedeljne, mesečne i godišnje) o aktivnostima nabavke.
- Po zahtevima i uputstvima neposrednog rukovodioca obavlja i druge poslove koji se odnose na procedure i procese nabavke i ugovaranja.

Potrebna akademska i stručna znanja:

- Univerzitetska diploma iz oblasti prava ili drugih oblasti u vezi sa odgovornostima organizacione jedinice.
- Profesionalna sertifikacija iz oblasti nabavke je prednost.
- Poznavanje engleskog jezika je prednost.

Potrebno profesionalno iskustvo:

- Najmanje dve (2) godine radnog iskustva u oblasti nabavke.

Posebni zahtevi:

- Veštine pismene komunikacije kao i sposobnost rešavanja problema prema prioriteta.
- Odlične kvantitativne i analitičke sposobnosti.
- Odlično poznavanje korišćenja računarskih sistema, MS Office i sl.
- Osoba sa visokom etikom i vešta u održavanju profesionalne tajne.
- Pažnja prema detaljima, janim formulisanjima i tačnosti.
- Samoinicijativnost i volja za timski rad.

Svi kandidati moraju dostaviti sledeća dokumenta:

- Zvanični obrazac za prijavu CBK-a;
- Propratno pismo (motivacija) u kojem se navodi interesovanje za ovu poziciju;
- **Dokaz o radnom iskustvu** (kopije ugovora ili potvrde poslodavca ili druga relevantna dokumenta koja služe za dokazivanje pozicije i radnog iskustva, ne dovodeći u pitanje relevantne akte o zaštiti ličnih podataka);
- **Izveštaj Kosovskog penzionog štednog fonda (Trusta)** za relevantni period, ili poreska potvrda Poreske administracije (PAK) kada izveštaj Fonda nije pravno primenljiv;
- Kopije diploma, dok diplome stečene van Republike Kosovo moraju biti zvanično priznate/ nostrifikovane od strane MONT-a;
- Dokaz o identitetu/kopija lične karte koja služi za dokazivanje kosovskog državljanstva.

Procedura prijave:

- Rok za prijavu je **26 mart 2025**.
- Prijava se može obaviti onlajn (<https://hris.bkk-kos.org>) preko zvanične internet stranice CBK-a ili preko arhive CBK-a. Ostali obrasci za prijavu neće se razmatrati.
- Obrazac za prijavu možete preuzeti preko zvanične internet stranice: www.bqk-kos.org



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook

www.facebook.com/gjeipuneshpejte

RESTAURANT

SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- N.T.SH. Ardi Shped O.P. nga Gjakova shpall të pavlefshme nr. Unik të biznesit 810223876të lëshuar nga ARBK.
- Raze Alija Bec KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e sh.f.m.u. "Ahmet Rrustemi" Bec Gjakovë.
- Diona Lila shpall të pavlefshme diplomën e gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.
- Korab Luzha nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. Teknike "Nexhmedin Nixha".
- Avenir Cengu shpall te pavlefshme 4 dëftesat Q.K "11 Marsi " Prizren.
- Flamur Kryeziu shpall te pavlefshme 3 dëftesat dhe diplomën Q.K "11 Marsi" Prizren.
- Eni Gashi shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IX shfmu " Hysen Rexhepi " Prizren.
- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.
- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)
- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.
- Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroj i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

